



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:014817

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05603577

CP:2023:014817

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil, me gjyqtaren Mirjeta Shala në çështjen juridike përmbarimore të kreditores V.B., e lindu ...nga Gjakova, me adresë rruga ... numër 24, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Nushi, avokat nga Prishtina, me seli të zyrës në rrugën “Mujo Ulqinaku”5/1, ndaj debitorit të përmbarimit A.B., nga Gjakova, rruga “...”nr.35, duke vendosur lidhur me lejimin e përmbarimit, që ka t ë bëjë me ndarjes e pasurisë së përbashkët, jashtë seancës gjyqësor, me datë 22 prill 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata Themelore në Gjakovë shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas propozimit të kreditores V.B., e lindur ... me numër Cp: 2023:014817 i datës 18.01.2023, ndaj kundër debitorit A.b., nga Gjakova, lidhur me çështjen juridike përmbarimore ndarjes e pasurisë së përbashkët.

II. HEDHET POSHT si i palejueshme propozimi i kreditores VB., e lindur ... me numër Cp: 2023:014817 i datës 18.01.2023, ndaj kundër debitorit A.B., , nga Gjakova, lidhur me çështjen juridike përmbarimore ndarjes e pasurisë së përbashkët, për shkak se kjo çështje nuk hyn në kompetencë gjyqësore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Kreditorja e përmbarimit V.B., e lindur ... nga Gjakova, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka ushtruar propozimin për përmbarim, në bazë të dokumentit ekzekutiv aktgjykimit C.nr.429/16 i datës 18.12.2017 i plotfuqishëm nga data 22.02.2022 i përmbarueshëm nga data 22.04.2022, i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, kundër debitorit A.B., nga Gjakova, me adresë rruga "...”nr.35, e cila është ka të bëjë me ndarjen e pasurisë së përbashkët të fituar gjatë martesës.

Gjykata, pas shikimit të shkresave të lëndës, konstatoj se në këtë çështje objekt përmbarimi është ndarja e pasurisë së përbashkët e fituar gjatë martesës e njohur sipas dokumentit përmbarues Aktgjykimi C.nr.429/19 i datës 18.12.2027, i plotfuqishëm nga data 22.02.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.04.2022.

Pas konstatimit të këtij fakti e duke iu referuar nenit 5 paragrafi 6 i Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-102, neni 3, ku është përcaktuar se *“Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: 6.1. të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë”, ndërsa par 7. Përmbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe zbatimin e përmbarimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës, gjykata gjeti se lidhur me përmbarimin në këtë çështje juridike përmbarimore, nuk ka kompetencë lëndore, kjo për faktin se me dispozitat e lartëcekura në mënyrë decisive janë përshkruar kompetencat e gjykatës si organ përmbarues dhe se përmbarimi i vendimit lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët e fituar gjatë martesë nuk hyn në kuadër të çështjeve nga e drejta familjare (pasi që nuk kemi të bëjë më çështjen e besimit të fëmijës, alimentacion apo diçka e ngjashme).*

Pas konstatimit të këtij fakti, gjykata duke u mbështetur në neni 18 par. 1 dhe 2 i LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 17 të LPP-së, ku është përcaktuar se *“Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore. 18.2 Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t'i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale te kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që*

i është paraqitur”, e lidhur me nenin 391 paragrafi 1 Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit i cili parashihet që “*pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të pa lejueshëm po që se .konstaton se[...] në pikën a)) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore*”, erdhi në përfundim se propozimi për përbarim në bazë të dokumentit përbarimorë Aktgjykimi C.nr.429/19 i datës 18.12.2027, i plotfuqishëm nga data 22.02.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.04.2022 me objekt përbarimi ndarja e pasurisë së përbashkët e fituar gjatë martesës, duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 e lidhur edhe me nenin 463 të LPK-së, kjo për faktin se gjykata lidhur me shpenzimet vendos vetëm me kërkesë të specifikuar të palës, e që në këtë fazë të procedurës, nuk kishte kërkesë të tillë.

Andaj nga theksimet e lartcekura, gjykata vendoset si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Cp.nr.2023:014817, datë 22.04.2024

Gjyqtarja
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.